

SENATI AKADEMIK

Nr. 54 Prot

Tiranë, më 20 . 01 . 2026

VENDIM

Nr. 2 , datë 20 . 01 . 2026

“Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në Universitetin “Metropolitan Tirana” për vitin akademik 2026-2027”

Në zbatim të Ligjit nr. 80 / 2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit e Rregullores së Brendshme të Universitetit “Metropolitan Tirana”, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19 . 01 . 2026, pasi shqyrtoi propozimet e fakulteteve lidhur me kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit për vitin akademik 2026-2027,

Vendosi:

1. Të miratojë propozimet e fakulteteve lidhur me kriteret e pranimit të studentëve në programet e studimit për vitin akademik 2026-2027 si më poshtë:
 - I. **Për programet e studimit me karakter profesional, pranimi është i mundur për çdo kandidat që:**
 - a. Ka përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe përmbush parashikimet ligjore në fuqi.
 - II. **Për programet e studimeve të ciklit të parë dhe ato të integruara të ciklit të dytë, pranimi është i mundur për çdo kandidat që:**
 - a. Ka përfunduar me sukses arsimin e mesëm dhe plotëson kriterin e notës mesatare, sipas përcaktimeve në VKM-në përkatëse;
 - b. Zotëron dëshminë e njohjes së gjuhës së huaj sipas udhëzimit në fuqi të MAS për programet e studimit në gjuhë të huaj;
 - c. Merr pjesë në zhvillimin e Testimit të Pranimit dhe të Bursave.
 - III. **Për programet e studimeve të ciklit të dytë, pranimi është i mundur për çdo kandidat që:**
 - a. Zotëron të paktën një program studimi të ciklit të parë, sipas specifikave të programit të studimit;



- b. Zotëron dëshminë e mbrojtjes të gjuhës së huaj sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- c. Do të kenë përparësi kandidatët që kanë notën mesatare të studimeve të ciklit të parë mbi 6;
- d. Për programet e studimit të ciklit të dytë, raste të veçanta që nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare përcaktuar në pikën 'c', në rast se do të ketë kuota të lira, do të shqyrtohen nga një komision i posaçëm;

IV. Për programet e studimeve të ciklit të tretë, pranimi është i mundur për çdo kandidat që:

- a. Ka përfunduar studimet e ciklit të parë dhe të dytë në fushën e shkencave të aplikuara dhe të ngjashme me to;
 - b. Zotëron një diplomë të ciklit të parë dhe të dytë (master i shkencave) ose diplomë të integruar të nivelit të dytë ose një diplomë sipas sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi brenda të njëjtës fushë ose të ngjashme, të përcaktuar në pikën më sipër;
 - c. Ka notë mesatare të studimeve universitare ≥ 8 , përjashtuar raste të veçanta të cilat do të gjykohen si të arsyeshme nga komisioni ad-hoc i përzgjedhjes së kandidatëve për programin e studimit të doktoratës;
 - d. Zotëron dëshmi të gjuhës angleze dhe mundësisht të gjuhës franceze në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse aplikanti ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga gjuhët e përmendura më sipër, diploma e fituar i shërben si dëshmi për plotësimin e kriterit të gjuhës së huaj.
2. Ky vendim i përcillet në formë shkresore Ministrisë së Arsimit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore, Rrjetit Akademik Shqiptar si edhe publikohet në Portalit U-Albania dhe në faqen zyrtare të internetit të Universitetit "Metropolitan Tirana".

Kryetari i Senatit Akademik

REKTORI

Prof. Dr. Nikolla CIVICI

